



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT MUNICIPALITY OF LIPJAN			
PRANUARË: PRIMLËNDJAH:		04.09.2026	
NUMERI JURIDIK	PRILLOJTI NR. 148/2026	NR. LËNDËS SR. PRONËS	SHTOJCA PRONË
08-	462/01-	46237	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463/02-17206, të datës 29.03.2024, i korrigjuar me Vendimin Nr.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024, Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - ZK në Lipjan, i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-29369, të datës 30.04.2026, shpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS – ZK LIPJAN

I. Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463/02-17206, të datës 29.03.2024, të korrigjuar me Vendimin Nr.15-462/01-22762 të datës 08.05.2024, si dhe me Vendimin për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në ZK Lipjan, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronën e paluajtshme me shënimet si vijon:

Parcela me nr. P-71409044-02454-0 në sipërfaqe prej 3302 m² – ZK Lipjan në pronësi të Komunës së Lipjanit (certifikata e pronës nr 148/2026 fp).

Parcela me P-71409044-02454-0 në sipërfaqe prej 3302 m² është e formuar me datën 14.03.2025 nga bashkimi i parcelave:

P-71409044-01736-1 në sipërfaqe prej 1110 m²
P-71409044-01742-4 në sipërfaqe prej 624 m²
P-71409044-01743-5 në sipërfaqe prej 803 m²
P-71409044-01748-2 në sipërfaqe prej 765 m²

Bashkimi i parcelave është bërë me Aktvendimin e Zyrës kadastrale komunale me nr. referent të lëndës: 164-2025 dhe certifikaten e pronës ***nr. 148/2026 fp***. Bashkimi i parcelave është bërë pas lidhjes së Kontratës Nr.01-463/02-9564 të datës 28.02.2025 për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr. 020/04-59398 të datës 29.11.2024. Megjithatë Kontrata me përfituesin është shfuqizuar, atëherë Vendimi i Kuvendit të Komunës

Mr. L. L. Fsh. B. J. B. K.

15Nr. 020/04-59398 i dates 29.11.2024 është anuluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-462/01-13683 të datës 24.03.2026.

Oëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës nr. P-71409044-02454-0 në sipërfaqe prej 3302 m² – ZK Lipjan, është ndërtimi i ndërtesave me shumë njësi banesore (afarizëm dhe banim) me etazhitet B+P+8. Ndërtimi mund të bëhet sipas kushteve të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës dhe vetëm pas arritjes së marrëveshjeve individuale me poseduesit e njësive banesore dhe pronarët e parcelave private.

Në parcelen komunale ndodhen dy ndërtesa të vjetra, ku me pronarët e banesave duhet arritur marrëveshje për dhënien e hapësirave të reja.

Ndërtesa e pare gjendet në pjesen jugore (afër stacionit policor) përgjatë rrugës “Lidhja e Prizrenit”:

Kjo ndërtesë ka etazhitet P+2, në bazë (shputë) ka 232 m². Në kuadër të ndërtesës ndodhen tetë (8) njësi banesore (disa prej tyre të adaptuara në lokale afariste). Prej tyre pesë (5) njësi janë të regjistruara në të dhënat kadastrale me nr. 01736-0-48-0 me sipërfaqe si në vijim:

Tabela 1: Njësitë banesore të regjistruara në ndërtesën e parë në kuadër të pronave komunale

Nr.	Të dhënat kadastrale për regjistrimin e njësisë	Sipërfaqja
1.	48-1-1-0	69.37 m ²
2.	48-1-4-0	54 m ²
3.	48-1-6-0	70 m ²
4.	48-1-9-0	70 m ²
5.	48-2-1-2-0	31.04 m ²

Në këtë ndërtesë nuk janë të regjistruara tri (3) njësi banesore, njëra me sipërfaqe prej 31.04 m² dhe dy të tjera me sipërfaqe nga 54 m². Shfrytëzuesit duhet të ofrojnë dokumentacionin përkatës për këto njësi banesore. Në të kundërtën veprohet sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërtesa e dytë në pjesen veriore (në drejtim të sheshit) përgjatë rrugës “Lidhja e Prizrenit”:

Kjo ndërtesë ka etazhitet B+P+1, në bazë (shputë) ka 288 m². Në kuadër të ndërtesës ndodhen tetë (8) njësi banesore (disa prej tyre lokale afariste). Shtatë (7) prej tyre janë të regjistruara në të dhënat kadastrale me nr. 01742-3-47-0 me sipërfaqe si në vijim:

Tabela 2: Njësitë banesore të regjistruara në ndërtesën e dytë në kuadër të pronave komunale

Nr.	Të dhënat kadastrale për regjistrimin e njësisë	Sipërfaqja
1.	47-1-1-0	52 m ²
2.	47-1-2-0	39 m ²
3.	47-1-3-0	39 m ²
4.	47-1-4-0	52 m ²
5.	47-1-5-0	52 m ²
6.	47-1-6-0	39 m ²
7.	47-1-7-0	39 m ²

Në këtë ndërtesë nuk është regjistruar një (1) njësi banesore me sipërfaqe prej 52m². Shfrytëzuesi duhet të ofrojë dokumentacionin përkatës për këtë njësi banesore. Në të kundërtën veprohet sipas legjislacionit në fuqi.

Në bodrumin e kësaj ndërtese janë të regjistruara 2 hapësira, kurse 6 të tjera jo.

Sh. L.P. Fsh RJ BK

Në të dy ndërtesat ekzitojnë hapësirat e përbashkëta apo edhe individuale (bodrome, terasa). Në të dy ndërtesat, në disa nga hapësirat e brendshme ka ndryshime faktike për shkak të adaptimeve nga shfrytëzuesit e tyre.

Në procesin e marrëveshjeve me shfrytëzuesit e njësive banesore, shfrytëzohen dokumentet e ligjshme të pronarëve dhe në bazë të kësaj përcaktohet sipërfaqja e saktë ndërtimore në këto dy ndërtesa. Lidhur me këtë, sipas nevojës mund të konsultohen organet kompetente të komunës.

Në procesin e tërësishëm të dhënies së pronave komunale, përfshihen për dhënie në shfrytëzim edhe parcelat e caktuara private. Me pronarët e këtyre parcelave, fituesi i ofertës duhet të arrij marrëveshje individuale me secilin pronar të parcelave. Parcelat private paraqiten në tabelen në vijim:

Tabela 3: Parcelat në pronësi private

Nr.	Pronësia	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Private	P-71409044 - 01740-7	Lipjan	154 m ²
2.	Private	P-71409044 - 01740-13	Lipjan	150 m ²
3.	Private	P-71409044 - 01740-12	Lipjan	261 m ²
4.	Private	P-71409044 - 01740-9	Lipjan	33 m ²
5.	Private	P-71409044 - 01740-10	Lipjan	21 m ²
6.	Private	P-71409044 - 01740-3	Lipjan	528 m ²

II. INFORMATAT LIDHUR ME NDËRTIMIN E NDËRTESES ME SHUMË NJËSI BANESORE I KOMBINUAR ME AFARIZËM

Blloku në të cilin është planifikuar ndërtimi, përbëhet nga parcela në pronësi të komunës në sipërfaqe prej 3302 m² dhe parcelat në pronësi private (Tabela 3) në sipërfaqe prej 1147 m² mund të zhvillohet vetëm si tërësi sipas kushteve të përcaktuara me Harten Zonale të Komunës.

Të gjitha parcelat, ajo në pronësi të komunës dhe ato private përfshijnë sipërfaqen prej 4449 m².

Ndërtesa/t mund të ndërtohet/n vetëm sipas kushteve të përcaktuara me HZK. Kushtet themelore sipas HZK janë:

Etazhiteti = B+P+8 (deri 32');

Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN) = vlera bazë 3 – vlera max.4;

Shfrytëzimi i sipërfaqes ndërtimore – deri 40%;

Sipërfaqja nëntokësore e parcelës - bodrumi - deri 60%;

Sipërfaqja gjelbëruese min. 30%;

Vija ndërtimore – min 15 m'

Vija ndërtimore nëntokësore – min 10 m'

Duhet të respektohen edhe kriteret tjera të përcaktuara me HZK dhe legjislacionin në fuqi. HZK është e publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës – Drejtorati për Urbanizëm.

Sipërfaqja e tokës duhet shfrytëzuar maksimalisht në kuadër të kriterëve të përcaktuara me HZK.

Handwritten signatures and initials: Fh. L.R. Fh. [initials] Bk

III. DETYRIMET E VEÇANTA PËR OFERTUESIN E PËRZGJEDHUR

Ofertuesi i përzgjedhur duhet të arrijë marrëveshje noteriale me shfrytëzuesit (pronarët) e njësive banesore në dy ndërtesat që gjenden në zonësi komunale për dhënie e hapësirave përkatëse (njësi banesore) në ndërtesën e re. Ofertuesi i përzgjedhur, po ashtu duhet të arrijë marrëveshje noteriale për ndërtim me të gjithë pronarët e pronave private për kompensimin me sipërfaqe të caktuar të njësive banesore dhe/apo lokaleve afariste. Proces i arritjes së marrëveshje është përgjegjësi e ofertuesit të përzgjedhur dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë ndërhyrje nga komuna.

Ofertuesi i përzgjedhur duhet të arrijë marrëveshje noteriale me shfrytëzuesit e njësive banesore dhe me pronarët privat të parcelave brenda gjashtë (6) muajve, duke llogaritur nga dita e nënshkrimit të kontratës për dhënie e tokës në shfrytëzim. Në rast të mos arritjes së marrëveshjeve me shfrytëzuesit e njësive banesore dhe pronarët e parcelave private brenda afatit të caktuar, shfuqizohet kontrata për dhënie e pronave në shfrytëzim.

Me arritjen e marrëveshjeve me pronarët, investitori duhet të aplikojë për kushte ndërtimore jo më vonë se 30 ditë pas arritjes së marrëveshjeve.

Investitori duhet të aplikojë me dokumentacion të kompletuar për leje ndërtimi jo më vonë se 3 muaj pas pranimit të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Njëkohësisht me këtë, investitori duhet të aplikojë edhe për leje rrënimi të ndërtesave ekzistuese.

Investitori brenda 60 ditëve pas marrjes së lejes së ndërtimit duhet të zgjidhë çështjet e akomodimit të banorëve sipas marrëveshjeve. Jo më vonë se kjo periudhë investitori duhet të fillojë me rrënimin e ndërtesave ekzistuese dhe me fillimin e ndërtimit sipas lejes ndërtimore.

Lidhur me zbatimin e detyrimeve sipas këtij Njoftimi, fituesi lidhë Kontratë me Kryetarin e Komunës për kushtet dhe afatin e realizimit të ndërtimit.

IV. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE

Sqarim: Në kuadër të kriterëve për përzgjedhjen e fituesit përfshihen tri grupe:

- Kriteret administrative (ligjore);
- Kriteret financiare; dhe
- Kriteret teknike/vlerësuese.

Kriteret administrative dhe financiare duhet plotësuar në tërësi nga ofertesit. Ofertesit që nuk i përmbushin një nga këto kriterë nuk përfshihen në vlerësim sipas kriterëve teknike.

IV/1. KRITERET ADMINISTRATIVE

1. Ofertuesi të ketë ndërtuar në dhjetë (10) vitet e fundit së paku një ndërtesë afariste dhe banimore me së paku 10000 m² apo 40 njësi banesore. (Dëshmi: Leja e ndërtimit). Ndërtesa/at duhet të jenë të pajisura me certifikatë përdorimi. Lidhur me këtë, duhet dëshmuar edhe pagesën e detyrimeve tatimore në ATK.

2. Subjekti i interesuar për ofertim sipas këtij njoftimi, nuk duhet të ketë tejkaluar lejet ndërtimore të lëshuara më parë nga Komuna për ndërtimet me shumë njësi banesore dhe afariste apo të ketë aplikuar për legalizim dhe paisur me certifikatë legalizimi. (Dëshmi: leja ndërtimore dhe certifikata e përdorimit).

3. Subjekti i interesuar për ofertim sipas këtij njoftimi, nuk duhet të ketë pasur më parë mosmarrëveshje apo çështje të pazgjidhura lidhur me çështjet e ndërtimit, ku komuna ishte e

Sh. L.R. Fsh BJ BK

përfshirë me të drejtat e saja (palë në kontratë me komunën), apo në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe respektim të kriterëve urbane. (Dëshmi: lejet e ndërtimit dhe certifikatat e përdorimit për ndërtesat e përfunduara).

4. Ofertuesi nuk duhet të ketë detyrime financiare të papaguara ndaj Komunës së Lipjanit, të evidentuara deri në datën e shpalljes së këtij Njoftimi. Dëshmi e njejtë kërkohet edhe nga ofertuesit e Komunave të tjera prej Komunës së tyre.

5. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për kryerjen e të gjitha detyrimeve ndaj ATK-së në tre (3) mujorin e fundit para dorëzimit të ofertave.

6. Vërtetimi nga Gjykata Komerciale se ofertuesi nuk është në procedurë të falimentimit, apo të ndonjë kontesti të natyrës ekonomike apo të shkeljeve të tjera ligjore, jo më i vjetër se 30 ditë.

7. Dëshmi që ndaj pronarëve të biznesit dhe biznesit si shoqëri tregtare nuk është nxjerrë aktgjykim i formës së prerë për kryerjen e vepres penale, jo më i vjetër se 30 ditë.

8. Subjektet ofertuese që aplikojnë si shoqëri tregtare, duhet të paraqesin dokumentacion përkatës të regjistrimit të subjektit në organin kompetentë. Nëse ofertuesit aplikojnë në grup (konzercium) atëherë secili subjekt duhet të plotësoj të ***gjitha kërkesat administrative dhe financiare***. Marrëveshja e ofertuesve duhet të jetë e noterizuar, ku përveç tjerash duhet përcaktuar të drejtat dhe detyrimet ndërmjet tyre, si dhe të përcaktohet bartësi i përgjegjësisë në raport komunikimi me Komunën.

IV/2. KRITERET FINANCIARE

1. Vlera e përafërt investive për ndërtimin e ndërtesës e bazuar në projektin ideor;
2. Dëshmi e qarkullimit financiar në fushën e ndërtimit në tetë (8) vitet e fundit në shumën min. prej 3 milion euro.
3. Letër konfirmimi për mbështetje financiare nga një bankë komerciale në Kosovë.

IV/3. KRITERET TEKNIKE (VLERËSUESE)

1. Vlera investive dhe numri i punonjësve

Vlera investive sipas projektit përfshinë shumën e parashikuar për ndërtim, duke pasur parasysh madhësinë e ndërtesës, produktet ndërtimore që përdoren dhe rregullimin e hapësirave të përgjithshme. Po ashtu duhet të prezantohet parashikimi për numrin e punonjësve që mund të angazhohen pas përfundimit të ndërtesës, duke pasur parasysh hapësirat e planifikuara për ushtrimin e veprimtarive afariste të lejuara. Do të konsiderohet vetëm një vlerë investive reale në proporcion me parcelen dhe madhësinë e ndërtesës.

Vlerësimi deri në 25 poena.

2. Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën

Në kuadër të përfitimit financiar dhe ekonomik për Komunën është me rendësi sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës dhe specifikisht ***përqindja e totalit të metrave katrorë (m2) neto të dhëna për Komunën në proporcion me sipërfaqen e pronës komunale, duke përfshirë përqindjen për njësi banesore, afarizëm dhe parkingjet në bodrum***. Përfitimi i m2 për Komunën paraqitet në sipërfaqe neto për njësitë banesore dhe lokalet afariste. Po ashtu edhe për hapësirat në bodrum



paraqitet sipërfaqja neto për Komunën por e zbërthyer në numër të parkingjeve dhe depove nëse parashihen në pjesën e bodrumit.

Në përqindjen e metrave katror për Komunën nuk përfshihen metrat katror për shfrytëzuesit e njësive banesore të dy ndërtesave që ndodhen në pronën komunale dhe të pronarëve të pronave private. Përqindja e kompensimit të shfrytëzuesve të njësive banesore dhe për pronarët e pronave private arrihet me marrëveshje ndërmjet fituesit të kontratës dhe pronarëve, prandaj kjo çështje nuk merret parasysh në vlerësim por është kusht për zbatimin e Kontratës së fituar.

Vlerësimi deri në 35 poena.

3. Projekti ideor- zgjidhja arkitektonike dhe përputshmëria me kriteret e HZK

1. Prezantimi i projektit ideor – zgjidhja arkitektonike. Në kuadër të projektit ideor duhet të përfshihen:

- 1.1. Respektimi i të gjitha kriterëve të përcaktuara me HZK;
- 1.2. Arritja e koeficientit brenda kufijëve të lejuar dhe sipas kriterëve të përcaktuara me HZK;
- 1.3. Përveç shputës së ndërtesës, hapësirat e lira dhe të gjelbërta duhet ta dominojnë parcelën, të cilat duhet të prezantohen qartësisht sipas kriterëve të HZK-së;
- 1.4. Qasja e personave me aftësi të kufizuara, mbrojtja nga zjarri në ndërtesë dhe koeficienti i përqueshmërisë termike në ndërtesë duhet siguruar në përputhje me Rregulloret në fuqi të miratuara nga MMPH;
- 1.5. Për secilen njësi banesore dhe lokale afariste duhet të ketë parkingje sipas kriterëve të përcaktuara me HZK. Të shqyrtohet mundësia që parkingjet për njësitë banesore të vendosen (sa më shumë) në bodrum;
- 1.6. Përshkrimi i materialeve ndërtimore që do të përdoren për ndërtim;
- 1.7. Materialet e fasadës duhet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjate, si dhe të rezistueshme ndaj zjarrit sipas kriterëve të përcaktuara ligjore (të specifikohet lloji i fasadës);
- 1.8. Arkitektura të jetë moderne, estetike dhe e qëndrueshme në aspektin energjetik. Lidhur me këtë duhet përshkruar/argumentuar me tekst, vizatime dhe formula adekuate.
- 1.9. Sistemi i instalimeve teknike të njësive banesore të bëhet sipas Rregullores MMPH Nr.04/2018.
- 1.10. Integrimi sa më i mirë i ndërtesës dhe ndërlidhja në kontekstin urban/rrethues duke marrë parasysh parkun dhe parkingun nëntokësor.
- 1.11. Energjia duhet të jetë efiçente sipas standardeve më të avancuara. Lidhur me këtë duhet prezantuar përshkrimin teknik në kuadër të projektit ideor.

Vlerësimi për të gjitha komponentet e projektit ideor bëhet – deri në 30 poena.

4. Afati kohor për ndërtim

Afati kohor i ndërtimit llogaritet nga dita e pajisjes me leje ndërtimi. Në kuadër të afatit të përgjithshëm për ndërtim duhet specifikuar periudhën e përfundimit të ndërtimit të vrazhdë dhe periudhën e përfundimit në tërësi të ndërtesës dhe lëshimi saj në përdorim. Ndërtesa konsiderohet e përfunduar vetëm pas marrjes së certifikatës së përdorimit.

Vlerësimi deri në 10 poena.

V. E DREJTA E APLIKIMIT

[Handwritten signatures in blue ink: Sh., LZ, Fh, BJ, Bh]

Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë Njoftim.

Ofertuesit e interesuar Aplikacionin mund ta marrin në sportelin e komunës në përdhësë “Qendra për Shërbime për Qytetarë” sporteli Nr.1 dhe 2 në formën fizike dhe në formë elektronike nga Uebfaqja e Komunës.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 100 € (njëqind euro).

Aplikacioni i kompletuar bashkë me oferten në kuvertë të mbyllur për parcelën kadastrale në Lipjan dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 1 dhe 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike pas ditës së publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri më datën 21.09. 2026 në ora 15:00.

Hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 22.09.2026 duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrësve në konkurim u sigurohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkurimi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik, emrin e personit përgjegjës apo të përfaqësuesit të autorizuar dhe funksionin e tij.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik apo të përfaqësuesit të autorizuar, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulloset nga personi përgjegjës i personit juridik apo të përfaqësuesit të autorizuar. Nëse oferta nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar, atëherë dorëzohet akti përkatës për përfaqësimin e ofertuesit.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kovertë të mbyllur.

Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për ZK - Lipjan sipas Njoftimit publik të datës 04.09.2026.

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.1 dhe 2 në formën fizike dhe në formë elektronike nga Uebfaqja e Komunës.

[Handwritten signatures in blue ink: J. L. P., F. B. J., B. K.]

Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për parcelen kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 1 dhe 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike pas ditës së publikimit të këtij Njoftimi.

Ofertat e pakompletuara, të paprecizuara, të panënshkruara, sipas aplikacionit, nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave mund të marrin pjesë përfaqësuesit ligjor të ofruesve apo të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

VI. KOMUNIKIMI

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës. *Pjesëmarrësit/ofertuesit do të njoftohen vetëm përmes postes elektronike zyrtare, në email adresat e prezantuara në aplikacion nga ana e ofruesve. Në aplikacion duhet të prezantohet qartë email adresa e ofruesit. Lëshimet eventuale në saktësinë e të dhënave mbeten nën përgjegjësinë e ofruesit.*

Informatat shitesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i tretë - Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

Me datë: 03.09.2026

KOMISIONI:

1. Imri Semetishti

2. Latif Ramadani

3. Fitim Shala

4. Besim Jusufi

5. Bekim Krasniqi